

Në bazë të nenit 21 të Ligjit për Planifikimin Hapësinor Nr. 04/L-174 dt. 23.08.2013, nenit 18 të Ligjit për Ndërtim Nr.04/L-110 dt. 31.05.2012, nenit 21 dhe 44 të Ligjit për Procedurën e Përgjithshme Administrative Nr. 05/L - 031 dt. 21.07.2016, nenit 17 pika "d" të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr. 03/L - 040, dt. 20.02.2008, nenit 15 pika "d" e Statutit të Komunës së Prishtinës Nr.110-391 dt.25.02.2010, UA të MMPH-së nr.06/2017 dt.23.05.2017 për caktimin e procedurave për përgatitjen dhe shqyrtimin e kërkesave për kushte ndërtimore, leje ndërtimore dhe leje rrënimi për kategorinë e I-rë dhe të II-të të ndërtimeve, Vendimit 14nr.350/05 – 0069714/18 dt.22.03.2018 të Kryetarit të Komunës së Prishtinës, "Për Përcaktimin e Mënyrës së Zbatimit të Dokumenteve të Planifikimit Hapësinor në Zonat Urbane", dhe duke vendosur sipas kërkesës 05 Nr.350/02– 14932/21 dt.25.01.2021, të kërkuarit / pronarit: Ndërmarrjes Publike Banesore Sh.A., për caktimin e kushteve ndërtimore për hartimin e dokumentacionit ndërtimor/projektin kryesor për ndërtimin e Kompleksit banesor -afarist, në kuadër të Bllokut Urban "A2", Tërësia "A" të Planit Rregullues "Lakrishte" në Prishtinë, Drejtoria e Urbanizmit e Komunës së Prishtinës, në procedurë të rregullt administrative, me datë 09.03.2021, merr këtë:

V E N D I M
CAKTIMI I KUSHTEVE NDËRTIMORE

I caktohen kushtet ndërtimore kërkuarit / pronarit: Ndërmarrjes Publike Banesore Sh.A., sipas kërkesës 05 Nr.350/02– 14932/21 dt.25.01.2021, për hartimin e dokumentacionit ndërtimor / projektin kryesor për ndërtimin e Kompleksit me ndërtesa banesore-afariste, në kuadër të Bllokut Urban "A2", Tërësia "A" të Planit Rregullues "Lakrishte" në Prishtinë, konkretisht parcelave kadastrale nr.7493-5, 7493-3, 7490-2, 7493-7, ZK.Prishtinë dhe parcelës kadastrale ne.7773-1, ZK.Prishtinë e cila pjesërisht planifikohet për këmbim.

II. Lokacioni i parcelave kadastrale për të cilat caktohen kushtet ndërtimore, përfshihet në kuadër të Planit Rregullues "Lakrishte" në Prishtinë, miratuar me Vendimin e KK Prishtinë 01nr.35 - 313 dt.24.07.2007, me destinim "Objekte me destinim për biznes, administratë, tregti dhe banim" dhe në kuadër të Planit Zhvillimor Urban miratuar me Vendimin e Kuvendit të Komunës së Prishtinë 01nr.035-181427 dt.24.09.2013 me destinim "Ndërtim i lartë i përzier".

Për kriteret, parametrat urban dhe kushtet e ndërtimit të përcaktuara me dokumentet të planifikimit hapësinor - Planit Rregullues "Lakrishte" dhe PZHU në Prishtinë, dhe konkretizuara me Vendimin 14nr.350/05 – 0069714/18 dt.22.03.2018 të Kryetarit të Komunës së Prishtinës, "Për Përcaktimin e Mënyrës së Zbatimit të Dokumenteve të Planifikimit Hapësinor në Zonat Urbane", kërkuari është informuar përmes shkresës zyrtare Informim nga Plani Rregullues Lakrishte dhe PZHU me nr.04-350/01-151476/20 dt.03.09.2020 lëshuar nga Drejtoria e Planifikimit Strategjik dhe Zhvillimit të Qëndrueshëm.

III. Gjendja ekzistuese e lokacionit/parcelave kadastrale sipas gjendjes kadastrale, pronësore, faktike & planifikimit urban;

- Numri, sipërfaqja, pronari & klasa e kualitetit të parcelës kadastrale, janë:

nr.7493-5; S=1,1590m ² ;	P.Sh.B.V.I për Banim; "tokë tjetër jo pjellore";
nr.7493-3; S=1,147m ² ;	P.Sh.B.V.I për Banim; "tokë tjetër jo pjellore";
nr.7490-2; S=4,007m ² ;	P.Sh.B.V.I për Banim; "arë e klasës 1";
nr.7493-7; S=1,000m ² ;	P.Sh.B.V.I për Banim; "tokë tjetër jo pjellore";

nr.7773-1; S=694m² ZK.Prishtinë, P.SH.Ujrat.....e planifikuar për këmbim;

Koeficienti ndërtimor i parcelës kadastrale, brenda vijës rregulluese/parcelës ndërtimore, do të llogaritet si në vijim: **100%** për etazhet mbi kuotën ± 0.00 , **50%** për etazhet me vëllim mbi **51%** mbi tokë - suteran, dhe **0%** për etazhet e nëntokës-bodrume, dhe kjo sipërfaqe është :
 $S=14,654m^2 \times 4.0=58,616.00m^2$; / lejuara me planin rregullues /
 $S=70,339.20m^2$ / sipas projekt propozimit duke llogaritur edhe kompensimin /

- Bazuar në Vendimin 01nr.400-660 dt. 26.05.2008 të Kryetarit të Komunës së Prishtinës, për kompensimin e pronës private, e përfshirë në hapësirë të paraparë për interes publik, me koeficient të ndërtimit, kjo sipërfaqe mund të shtohet për $S=2,930m^2$, gjegjësisht sipërfaqja ndërtimore e lejuar do të jetë $S=2930 \times 4.0=11,720.00m^2$. Sipërfaqja e përgjithshme ndërtimore maksimale e lejuar është: $S=58,616.00+11,70.00=70,336m^2$;
- Bazuar në kriteret e planit rregullues urban, distanca anësore e ndërtesave të banimit kolektiv, për ndërtesa në varg, të pa ndërprera është 0m, për ndërtesa në vargun e ndërprerë së paku 5m, për ndërtesa të veçanta është së paku 8m; Për pjesën e nëntokës distanca minimale të jetë 1.5m, në të kundërtën nëse kjo distancë është më e vogël ose ndërtohet në kufi, duhet të sigurohet pëlqimi i vërtetuar nga pronari i parcelës fqinje;
- Etazhiteti maksimal për Bllokun urban "A1", Tërësia "A", sipas planit rregullues, nuk është i përcaktuar, por i njëjti definohet me sipërfaqen ndërtimore dhe shfrytëzimin e parcelës, ku ky etazhitet mund të ndryshohet - rritet me aplikimin e Vendit 01nr.400-660 dt.26.05.2008, të Kryetarit të Komunës së Prishtinës, për shpronësimin / kompensimin e pronës private të paraparë për interes publik, me koeficient të ndërtimit;
- Bazuar në nenin III. të Vendimit të Kryetarit të Komunës së Prishtinës dt. 14.08.2016, protokoluar me numrin 01nr.031-185481, për arsye të kursimit dhe efijencës së energjisë, sipërfaqja që zë shtresa e termoizolimit në fasadat e ndërtesës, nuk do të përfshihet në kalkulimin e sipërfaqes së përgjithshme ndërtimore (ISPN), e as në kalkulimin për taksën e lejes ndërtimore;
- Përdhesa nga niveli i terrenit- trotuarit të ndërtesës, lejohet të ngritet max.0.3m';
- Qasjet në kompleks të jenë nga rruga "Ukshin Hoti" e cila është edhe rrugë e planifikuar e planit rregullues, dhe e njëjta është korrigjuar me vendimin;
- Në kuadër të kompleksit të parashihen edhe vendparkimet e jashtme, shtigjet, trotuaret kënde të lojrave për fëmijë, terrene sportive, mobiluar urban, etj.;
- Parkimi i makinave për nevojat e pronarëve(shfrytëzuesve) të objekteve të banimit, si dhe të gjitha tipeve të ndërtimit, sigurohet në parcelën ndërtimore në brendi të bllokut. Për objektet e banimit kolektiv, standardi i parkimit respektivisht garazhimit është një parking(vendgarazhim)për një banesë me kusht që së paku 80% e makinave të jenë të vendosura në garazh.Numri i parkingjeve përcaktohet në bazë të kriterëve të PRR dhe UA të MMPH Nr.08/2017 për normat teknike të planifikimit hapësinor, të përcaktohen vendparkimet dhe garazhimet.
- Në kuadër të kompleksit të parashihet hapësira për grumbullimin & vendosjen e mbeturinave;
- Arkitektura - dukja e jashtme (fasada) e ndërtesës dhe materializimi i saj, të jetë me materiale bashkëkohore, masa të efijencës së energjisë, dhe të përshtatet me destinimin e ndërtimit;
- Të bëhet aplikimi i kushteve tjera urbane & arkitektonike të përcaktuara në kriteret dhe parametrat urban të Plani Rregullues "Lakrishte" në Prishtinë dhe UA të MMPH Nr.08/2017 për normat teknike të planifikimit hapësinor si dhe normat tjera të planifikimit për llojin e ndërtimit.

V. Kompensimi / shpronësimi me koeficient ndërtimi i pjesve të parcelave kadastrale: nr.7493-5, 7493-3, 7490-2, 7493-7, ZK.Prishtinë, me $S=2,930m^2$, e përfshirë në hapësirë publike të planifikuar – rrugë, të realizohet si më poshtë:

Sipas kalkulimeve në paragrafin IV, parcela ndërtimore e kompleksit në kuadër të Bllokut urban "A2" është me sipërfaqe prej $S=14,654m^2$ andaj bazuar në Vendimin e Kryetarit të Komunës së Prishtinës 01 nr.400-660 dt. 26.05.2008, kompensimi i pronës private të përfshirë

në hapësira me interes publik, mund të realizohet me koeficient të ndërtimit për sipërfaqet deri 20%, dhe sipas kësaj, kjo sipërfaqe, përcaktuar në përqindje (%) është $S=14,654 * 0.2=2,930m^2$. Andaj sipas këtij kalkulimi, pronari për sipërfaqen e theksuar, do të kompenzohet me sipërfaqe ndërtimore: $S=2,930 \times 4.0=11,720m^2$;

Kjo drejtori jep PËLQIM për kompensimin / shpronësimin me koeficient ndërtimi të pjesës së parcelës kadastrale, bazuar në vendimin e lartcekur. Kjo procedurë e kompensimit / shpronësimit me koeficient ndërtimi, do të realizohet bazuar në pëlqimin e konfirmuar në këtë paragraf, i cili do të shërbejë si bazë për arritjen e marrëveshjes definitive, në mes të pronarit të parcelës dhe Komunës së Prishtinës, konkretisht Drejtorisë së Pronës të Komunës së Prishtinës.

Mos zbatimi i kësaj procedure sipas këtij paragrafi, nga pronari & investitori, për arsye të ndryshme, obligon Drejtorinë e Urbanizmit, të rishikojë sipërfaqet ndërtimore të ndërtesës përcaktuara me këtë vendim për caktimin e kushteve ndërtimore.

VI. Ndarja / parcelimi i parcelave kadastrale nr.7493-5, 7495-3, 7490-2, 7493-7, ZK.Prishtinë, do të realizohet sipas parcelës ndërtimore, të përcaktuar me vijën rregulluese dhe rrugën e planifikuara të planit rregullues urban dhe bazuar në Plani i situacionit – “zgjidhja urbane” dhe manualin e ndarjes, punuar nga gjeodeti Haki Selmani me nr. te lic.11.

Kjo drejtori jep PËLQIM për ndarjen e parcelave kadastrale të lartcekura, sipas Planit të situacionit - “zgjidhja urbane” dhe manualit të ndarjes. Procedura e ndarjes / parcelimit do të realizohet bazuar në pëlqimin e konfirmuar në këtë paragraf, e i cili do të shërbejë si bazë për evidentimin në regjistrin kadastral, të këtyre ndryshimeve.

Procedura e ndarjes të bëhet para aplikimit për leje ndërtimore, në Drejtorinë e Kadastrit të Komunës së Prishtinës, sipas këtyre kushteve ndërtimore dhe me kërkesë të pronarëve & investitorit, duke u bazuar edhe në, Plani i situacionit - “zgjidhja urbane” dhe manualin e ndarjes së parcelës, punuar nga gjeometri i licencuar, e të cilat janë pjesë përbërëse të këtij vendimi për caktimin e kushteve ndërtimore.

VII. Këmbimi i parcelës kadastrale nr.7773-1, ZK Prishtinë, me $S=694m^2$ në pronësi/posedim të P.SH. Ujrat, Prishtinë, me pjesën e parcelës kadastrale nr.7490-2ZK.Prishtinë në pronësi të P.Sh.B.V.I për Banim, me $S=694m^2$ (e destinuar si “destinim publike”), dhe do të realizohet bazuar në kushtet ndërtimore, vlerësimin e organit kompetent dhe rregullativën ligjore në fuqi.

Andaj drejtorja kërkon dhe jep PËLQIM për këmbimin e parcelave të lartcekura, sipas Planit të situacionit-“zgjidhjes urbane” të parcelës ndërtimore me vijën rregulluese dhe ndërtimore dhe Manualit të ndarjes punuar nga gjeometri i licencuar dhe bazuar në Ligjin Nr.04/L-144 për Dhënien në Shfrytëzim dhe Këmbimin e Pronës së Paluajtshme të Komunës. Procedura e këmbimit do të realizohet bazuar në pëlqimin e përshkruar në këtë paragraf, e i cili do të shërbejë si bazë për evidentimin në regjistrin kadastral, të këtyre ndryshimeve.

Procedura e këmbimit do të realizohet, para aplikimit për leje ndërtimore në Drejtorinë e Pronës së Komunës së Prishtinës, sipas këtyre kushteve ndërtimore, me kërkesë të pronarëve dhe investitorit, duke u bazuar në Situacioni i parcelës ndërtimore me vijën rregulluese dhe ndërtimore nga Plani Rregullues “Lakrishte” në sistemin koordinativ KosovaREF 01, punuar nga gjeodeti i licencuar, i cili është pjesë përbërëse e këtij vendimi për caktimin e kushteve ndërtimore.

Mos zbatimi i kësaj procedure sipas këtij paragrafi, nga pronarët dhe investitori, për arsye të ndryshme, obligon Drejtorinë e Urbanizmit, të rishikojë vendimin e kushteve ndërtimore, gjegjësisht anulimin e tyre.

VIII. Bashkimi i pjesëve të parcelave kadastrale, nr.7493-5, 7493-3, 7490-2, ZK.Prishtinë dhe pjesës së parcelës kadastrale ne.7773-1, ZK.Prishtinë e cila planifikohet të këmbehet,sipas parcelës ndërtimore bazuar në Plani i situacionit – “zgjidhja urbane” dhe manualin e bashkimit të parcelave, punuar nga gjeometri i licencuar, do të bëhet në një parcelë të vetme - parcelë ndërtimore.

Andaj, kjo drejtori jep PËLQIM për bashkimin e pjesëve të parcelave të lartcekura sipas, Planit të situacionit-“zgjidhja urbane” dhe manualit të bashkimit të parcelave, e i cili do të shërbejë si bazë për evidentimin në regjistrin kadastral, të këtyre ndryshimeve. Procedura e bashkimit të do të bëhet para aplikimit për leje ndërtimore, në Drejtorinë e Kadastrit

të Komunës së Prishtinës, sipas këtyre kushteve ndërtimore dhe me kërkesë të pronarëve dhe investitorit, duke u bazuar në Plani i situacionit-“zgjidha urbane” dhe manualin e bashkimit të parcelave, punuar nga gjeometri i licencuar, i cili është pjesë përbërëse e këtij vendimi për caktimin e kushteve ndërtimore.

IX. Kycja në infrastrukturë - marrja e pëlqimeve nga KEDS-i dhe KUR “Prishtina”, bëhet me aplikim nga kjo drejtori. Për aplikim nevojitet prezantimi i dokumentacionit, me përcaktim të vendeve për kycje në rrjetet përkatëse, dorëzuar veçantë në CD, me përmbajtje si në vijim:

- *Emri (prindi) mbiemri i aplikuesit dhe numri i identifikimit dhe adresa;*
- *Informatën mbi lokacionin-adresa e saktë e hapësirës ndërtuese;*
- *Kopjen e planit dhe certifikatën e njësisë kadastrale;*
- *Planin e situacionit (dispozita urbanistike pjesë përbërëse e kushteve ndërtimore) dhe pamjen në ortofoto të lokacionit me hapësirën ndërtuese;*
- *Përshkrimin teknik të objektit (destinimi dhe kapaciteti i nevojshëm për elektrike dhe ujë).*

Kycja në infrastrukturë për ngrohje qendrore të bëhet në rrjetin ekzistues, pas sigurimit paraprak të kushteve detale dhe pëlqimit për kycje nga “Termokos”-Ngrohtorja e Qytetit sh.a. dhe PTK.

X. Dokumentacioni ndërtimor - projekti kryesor, të hartohet nga ekipi me përgatitje të lartë profesionale dhe me kualifikime përkatëse për secilën fazë të projektit, duke u bazuar në kushtet ndërtimore të caktuara në pikën IV., projekt propozimin e prezantuar, “Rregulloren mbi normat minimale teknike për ndërtesat e banimit në bashkëpronësi”, të MMPH nr. 03/2016 dt. 04.11.2016, “Udhëzimit Administrativ MMPH-së 08/2017 për Normat Teknike të Planifikimit Hapësinor”, bazuar në UA të MMPH-së Nr.33/2007 për kushtet teknike të objekteve ndërtimore për qasjen e personave me aftësi të kufizuara, normave teknike për siguri nga zjarri si dhe normave dhe standardeve tjera për projektim të kësaj kategorie të ndërtesës, dhe të përmbajë:

- *Lokacionin e parcelës ndërtimore në kuadër të zonës;*
- *Situacionin - Planin e lokacionit, të gjerë në diametër prej 50m`, me ndërtesat ekzistuese dhe të planifikuara, në përpjesë 1:200, 1:500 apo 1:1000;*
- *Situacionin - Planin e lokacionit 1:200 ose 1:500, me dimensione të shënuara, horizontale dhe vertikale-kuota të lartësisë, relative dhe absolute;*
- *Situacionin - “zgjidhja urbane” në përpjesë 1:200 ose 1:500, me dimensione të shënuara, horizontale dhe vertikale-kuota të lartësisë me pozicionim të ndërtesave në sistemin koordinativ KosovaREF01, duke përfshirë edhe kuotat vertikale të hyrjeve në përdhese me kuota të shënuara, relative dhe absolute;*
- *Incizimin gjeodezik të parcelës ndërtimore me rrethinë, si dhe me pozicionim të ndërtesave të projektuara dhe infrastrukturës rrugore, në sistemin koordinativ KosovaREF 01;*
- *Të gjitha bazat, prerjet dhe dukjet e fasadave, në përpjesë 1:50, për ndërtesat e projektuara, duke përfshirë edhe kuotat vertikale të hyrjeve në përdhese dhe etazheve tjera, me kuota të shënuara, relative dhe absolute;*
- *Përshkrimin teknik me paramasë dhe parallogari të punëve ndërtimore dhe ndërtimore-zejtare;*
- *Detajet e nevojshme, në përpjesë 1:5, 1:10 apo 1:20 dhe specifikimin e zdrukthëtarisë, me përshkrimin e materialit të dyerve dhe dritareve, në përpjesë 1:50;*
- *Projektin e organizimit të kompleksit, me rugë, shtigje, mobiljarin urban, etj;*
- *Projektin e strukturës së ndërtimit-llogarinë statike, me përshkrim teknik, pozicionimin dhe detaje e nevojshme;*
- *Projektin e instalimeve elektro – energjetike, me përcaktimin e vendit për kycje në rrjetin energjetik të qytetit dhe pozicionimin e trafostacionit;*
- *Projektin e instalimeve të ujësjellësit dhe kanalizimit, me përcaktimin e vendit për kycje në rrjetin e qytetit;*
- *Projektin e instalimeve të makinerisë, me përcaktimin e vendit për kycje në rrjetin e qytetit;*
- *Elaborati i “Organizmi dhe masat e sigurisë në vend ndërtim”, bazuar në Vendimin 01nr.035-174324 dt.12.07.2016, e Kryetarit të Komunës së Prishtinës;*

- *Elaboratin e fizikës ndërtimore dhe atë të mbrojtjes nga zhurma;*
- *Elaboratin gjeomekanik, në bazë të analizave të zhvilluara në terren;*

XI. Dokumentacioni ndërtimor për Masat e mbrojtëse nga zjarri të hartohet nga ekipi me përgatitje të lartë profesionale dhe kualifikim përkatës. Me aplikacionin për leje ndërtimore të dorëzohet dokumentacioni i nevojshëm, në dosje të veçantë, i cili përmes aktit përcjellës, do të procedohet nga kjo drejtori në kompetencë të Drejtorisë së Shërbimeve Publike, Mbrojtjes dhe Shpëtimit të Komunës së Prishtinës, për sigurimin e "Deklaratë" për Masat e mbrojtjes nga zjarri. Dokumentacioni i përgatitur duhet të përmbajë:

- *Planin e mbrojtjes nga zjarri-elaboratin, të hartuar nga kompani apo individ i licencuar;*
- *Dëshminë mbi pronësinë për parcelën kadastrale/certifikatën e njësisë kadastrale dhe kopjen e planit (kopje);*
- *Situacionin-planin e lokacionit, të gjerë në diametër prej 50m², me ndërtesa ekzistuese dhe ndërtesat e planifikuara, në përpjesë 1:200, 1:500 apo 1:1000;*
- *Situacionin-"zgjidhja urbane" në përpjesë 1:200 ose 1:500, me pozicionim të ndërtesave në sistemin koordinativ KosovaREF01, duke përfshi edhe kuotat vertikale të hyrjeve në përdhese, me kuota relative dhe absolute;*
- *Kushtet ndërtimore, të caktuara nga Drejtoria e Urbanizmit (kopje);*
- *Certifikatën e regjistrimit të biznesit të investitorit dhe të hartuesit të planit të mbrojtjes nga zjarri.*

Dokumentacioni ndërtimor për Leje Mjedisore Komunale të hartohet nga ekipi me përgatitje të lartë profesionale dhe kualifikim përkatës, dhe aplikimi të bëhet në Drejtorinë e Planifikimit Strategjik dhe Zhvillimit të Qëndrueshëm, njëkohësisht me aplikimin për leje ndërtimore. Dokumentacioni i përgatitur duhet të përmbajë:

- *Raporti për Leje Mjedisore Komunale, në tre (3)kopje në formë të shkruar dhe një (1) në formë elektronike;*
- *Certifikatën për regjistrimin e biznesit;*
- *Certifikatën e njësisë kadastrale dhe kopjen e planit.*

XII. Marrëveshja për infrastrukturë – bazuar në nenin 23 të Ligjit Nr.04/L-110 për Ndërtim dhe në nenin 10 dhe 11 të "Rregullore mbi Taksën administrative për dhënien e lejes së ndërtimit dhe Tarifën për rregullimin e infrastrukturës" 01 nr. 434/01–0094474/17 dt. 24.04.2017, obligohet Drejtoria e Investimeve Kapitale dhe Menaxhimit të Kontratave të Komunës së Prishtinës, të vlerësojë një ngarkesë për të rimbursuar koston për krijimin, përmirësimin, zgjerimin apo riparimin e infrastrukturës, dhe të arrijë marrëveshje për infrastrukturë me pronarin / investitorin.

Me aplikacionin për leje ndërtimore të dorëzohet dokumentacioni i nevojshëm, në dosje të veçantë, i cili përmes aktit përcjellës, do të procedohet, nga kjo drejtori, në kompetencë të Drejtorisë së Investimeve Kapitale dhe Menaxhimit të Kontratave të Komunës së Prishtinës, për arrijtjen e kësaj marrëveshjeje. Dokumentacioni i përgatitur duhet të përmbajë:

- *Dëshminë mbi pronësinë për parcelën kadastrale/certifikatën e njësisë kadastrale dhe kopjen e planit (kopje);*
- *Vendimi për caktimin e kushtet ndërtimore, së bashku me situacionin e miratuar, të lëshuar nga kjo drejtori;*
- *Certifikatën e regjistrimit të biznesit të kompanisë investuese;*
- *Kontratën për bashkëinvestim (nëse është prezantuar në kërkesën për leje ndërtimore);*
- *Autorizimin për përfaqësim (nëse është prezantuar në kërkesën e lejes ndërtimore);*
- *Kopjen e letërnjoftimit të kërkuësit/ve (bashkëpronarëve të parcelës-ave dhe investitorit);*

XIII. Pagesa e taksës administrative për leje ndërtimi dhe tarifës për ndikimet nga rritja e densitetit të infrastrukturës, do të kalkulohet/realizohet sipas "Rregullore mbi Taksën Administrative për dhënien e lejes së ndërtimit dhe Tarifën për rregullimin e infrastrukturës" 01nr.434/01 – 0094474/17 dt.24.04.2017 dhe dokumentacionit ndërtimor / projektin kryesor, si pjesë përbërëse e kërkesës për leje ndërtimore. Pagesa e taksës & tarifës, sipas këtij paragrafi, do të realizohet sipas afatit kohor të përcaktuar në paragrafin 4 të nenit 16 të UA të MMPH-së Nr.06/2017 dt.23.05.2017, pas marrjes së konfirmimit për pagesë.

Pagesa e taksës administrative do të llogaritet edhe për rrënimin e ndërtimeve ekzistuese në kuadër të parcelës kadastrale, bazuar në gjendjen ekzistuese, incizimin gjeodezik dhe projektin ideor të atyre ndërtimeve, me pagesën e taksës së përcaktuar në pikën 5.9 të nenit 5 të rregullores së lartcekur dhe vendimit për lejimin e rrëimit.

XIV. Vërejtje: Para aplikimit për leje ndërtimore duhet të bëhet ndërtimi destinimit të pjesës së parcelës kadastrale 7,493-5 me S=302m², e cila sipas gjendjes faktike kalon në zonën e shkollës gjegjësisht bllokun A6, në hapësirë publike.

XV. Vlefshmëria e vendimit të kushteve ndërtimore është një (1) vit, me mundësi të vazhdimin për një (1) vit tjetër, në rastet kur nuk ka ndërruar gjendja ekzistuese apo dokumenti i planifikimit hapësinor, dhe me aplikim para skadimit të afatit të vlefshmërisë së tyre.

A r s y e t i m

Kërkuesi / pronari, Ndërmarrjes Publike Banesore Sh.A, me kërkesën 05 Nr.350/02–14932/21 dt.25.01.2021, ka kërkuar nga kjo drejtori caktimin e kushteve ndërtimore për hartimin e dokumentacionit ndërtimor / projektin kryesor për ndërtimin e Kompleksit të ndërtesave shumnëbanesore afgangiste, në lokacionin e përshkruar në paragrafin I. të dispozitivit të këtij vendimit.

Me kërkesë për kushte ndërtimore 05 Nr.350/02– 14932/21 dt.25.01.202 dhe plotësuar me shkresën "Plotësim dokumentacioni" 05nr.350/02– 14932/21/1 dt. 19.02.2021 dhe 05-350/02-14932/21/1 dt.12.03.2021, si dhe gjat fazës së trajtimit të kërkesës është prezantuar dhe trajtuar ky dokumentacion:

- *Dëshminë mbi pronësinë: certifikatën e njësisë kadastrale dhe kopjen e planit për parcelat kadastrale: nr.7493-5, 7495-3, 7490-2, 7493-7, ZK.Prishtinë*
- *Projekt propozimin konceptual – "zgjidhjen urbane", me zgjidhje dhe sipërfaqet ndërtimore të ndërtesës, hartuar nga NPB.Sh.A, me certifikatë të regjistrimit të biznesit me nr.810500604, Departamenti i Planifikimit, Projektimit dhe Mbikqyrjes;*
- *Informatën nga plani me nr.04-350/01-151476/20 dt.03.09.2020, të lëshuar nga Drejtorja e Planifikimit Strategjik dhe Zhvillimit të Qëndrueshëm;*
- *Incizimin gjeodezik të gjendjes faktike të parcelës me rrethinë, punuar nga gjeodet Haki Selmani, me nr. te lic.11 dhe SHaqir B.Kuçi, me nr. të lic.86;;*
- *Autorizimin e NPB për Dardan Kuçin, lëshuar nga Hajdar Hoxha, kryeshef ekzekutiv.*
- *Kopjen e Vendimit të shpronësimit Nr.09/29 dt.03.08.2011;*
- *Vërtetimin e tatimit në pronë me Nr.10-430/03-0007207/21 dr.13.01.2021 në emër të NSH NDËR.PUB.BAN;*
- *Fotografitë e gjendjes ekzistuese;*
- *Kopjet e letërnjoftimit të autorizuesit dhe të autorizuarit;*
- *Manuali i ndarjes së parcelës punuar nga gjeodet Haki Selmani me nr. te lic.11.*

Drejtorja e Urbanizmit e Komunës së Prishtinës, në procedurën e shqyrtimit të kërkesës për kushte ndërtimore 05 Nr.350/02– 14932/21 dt.25.01.202 dhe plotësuar me shkresën "Plotësim dokumentacioni" 05nr.350/02– 14932/21/1 dt. 19.02.2021, dokumentacionit të bashkëngjitur, konsultimit të dokumenteve të planifikimit hapësinor për lokacionin ku shtrihen parcelat, Planin Rregullues Urban "Lakërishte" dhe Vendimin 14nr.350/05 – 0069714/18 dt.22.03.2018 të Kryetarit të Komunës së Prishtinës, rregullativën tjetër ligjore në fuqi, nga lëmi i planifikimit, ndërtimit dhe procedurës së përgjithshme administrative, si dhe konsultimit të projekt propozimit – Projektit konceptual me "zgjidhja urbane" dhe projekti ideor të prezantuar, në mënyrë kronologjike ka konstatuar se:

Parcelat kadastrale, nr.7493-5, 7495-3, 7490-2, 7493-7, ZK.Prishtinë, me sipërfaqe totale prej S=17,744.00m², përfshihet në kuadër të Bllokut urban "A2" Tërësia "A" të Planit Rregullues "Lakërishte", konkretisht me sipërfaqe prej S=14,654m², brenda bllokut urban, ku sipas këtij plani kjo hapësirë është e destinuar si "Objekte me destinim për biznes, administratë, tregti dhe banim", dhe pjesërisht, me sipërfaqe prej S=3,044m², shtrihet në rugën ekzistuese dhe

njëkohësisht, është edhe rrugët e planifikuara e planit rregullues urban, ndërsa sipërfaqja prej 2,930m² bazuar ne Vendimin 01nr.400-660 dt.26.05.2008 të Kryetarit të Komunës së Prishtinës, do të kompensohet me koeficient ndërtimi, sipas kushteve të përcaktuara në paragrafin V. të këtij vendimi.

Drejtoria e Urbanizmit pas analizimit të Plani i situacionit – “zgjdhja urbane” me projekt propozim konceptual, dhe në mbështetje të rregullativës ligjore në fuqi, konkretisht nenit 18 të Ligjit të Ndërtimit nr. 04/L-110 dt. 31.05.2012, nenit 21 të Ligjit për Planifikim Hapësinor Nr.04/L-174 dt.31.07.2013 dhe nenin 13 të “Udhëzimi Administrativ i MMPH-së Nr.06/2017 për përcaktimin e procedurave për përgatitjen dhe shqyrtimin e kërkesave për kushte ndërtimore, leje ndërtimore dhe leje rrënimi për kategorinë e I-rë dhe II-të të ndërtimeve”, me datë 25.02.2021 ka vendosur “Njoftimi publik” i cili ka qëndruar gjer me datë 11.03.2021, ku sipas rregullativës ligjore të lartë cekur para caktimit të kushteve ndërtimore, publiku i rrethinës duhet të informohet me synimin e kërkuësve dhe ofrimin e mundësin për dhënien e komenteve të pronarëve / poseduesve të rrethinës në diametrin e dritës prej 50m’, por gjatë kësaj periudhe në postën elektronike të vendosur në afishen e njoftimit publik nuk ka arritur ndonjë koment.

Nëse i referohemi Blloku urban “A2” i Tërësisë “A”, ky bllok përveq rrugëve të planifikuara me plan poashtu kufizohet edhe me trasenë e planifikuar Revitalizimi i lumit Prishtina dhe lumit Vellusha”. Si ecuri e planifikimit, gjegjësisht renditja e dokumenteve të planifikimit për zonat urbane është si në vijim: 1.Plani Rregullues “Lakrishte”, i miratuar me dt.24.07.2007 i cili ka të përcaktuar kriteret e zhvillimit, 2.Plani Zhvillimor Urban-PZHU, miratuar me dt.24.09.2013 i cili obligon që cdo leje të jetë në harmoni me këtë plan dhe Vendimi 14nr.350/05 – 0069714/18 dt.22.03.2018 të Kryetarit të Komunës së Prishtinës, “Për Përcaktimin e Mënyrës së Zbatimit të Dokumenteve të Planifikimit Hapësinor në Zonat Urbane” për ato zona ku ka mos harmonizim në mes të planeve rregulluese urbane dhe PZHU-së.Duke u bazuar në Vendimin 14nr.350/05 – 0069714/18 dt.22.03.2018 gjegjësisht 2 të nenit 5 të Vendimin 14nr.350/05 – 0069714/18 dt.22.03.2018 të Kryetarit të Komunës së Prishtinës, në bazë të të cilit përcaktohet mënyra e zbatimit të dokumenteve të planifikimit të hapësinor, dhe duke u bazuar në incizimin gjeodezik të gjendjes faktike, ku shihet se blloku është realizuar nën 50%, ky bllok vazhdon zhvillimin me të gjitha kriteret dhe parametrat e PRRU-së përveq koeficientit të ndërtimit (ISPN) dhe koeficientit të shfrytëzimit të parcelës (ISHP), i cili duhet të përvetësohet sipas PZHU-së, e që është ISPN 3.0-4.0 dhe ISHP max.40% përderisa me Plan Rregullues të njëjtan kanë qenë: ISPN ka qenë 5 dhe ISHP 50%;

Andaj, bazuar në këtë Vendimin e lartcekur dhe kriteret e Planit Rregullues Urban “Lakrishte”, janë përcaktuar kriteret, parametrat dhe kushtet për hartimin e dokumentacionit ndërtimor për parcelat kadastrale nr.7493-5, 7495-3, 7490-2, 7493-7, ZK.Prishtinë.

Në analizën e situacionit nga aspekti i komunikacionit dhe prezantuar në shkresën e zyrtarit në kuadër të drejtorisë për komunikacion, është përcaktuar rregullsia e kompleksit dhe kyçja e sajë nga aspekti i komunikacionit, si dhe janë përcaktuar masat që duhet të ndërmerren, për kyçje të kompleksit në rrugën e brendshme të bllokut dhe e njëjta me rrugën e planifikuar.

Bazuar në konstatimet e më sipërme, rregullativën ligjore në fuqi, konkretisht nenin 18 të Ligjit për Ndërtim Nr. 04/L-110 dt. 31.05.2012, nenin 21 të Ligjit për Planifikim Hapësinor Nr. 04/L-174 dt. 31.07.2013, nenin 7 dhe 8 të UA të MMPH-së Nr.06/2017 dt.23.05.2017 për përcaktimin e procedurave për përgatitjen dhe shqyrtimin e kërkesave për kushte ndërtimore, leje ndërtimore dhe leje rrënimi për kategorinë e I-rë dhe II-të të ndërtimeve”, dhe diskrecionin ligjor që e përcakton Ligji për ndërtim dhe ai i Procedurës së Përgjithëshme Administrative, Drejtoria e Urbanizmit ka konstatuar se kërkuësit kanë prezantuar të gjithë dokumentacionin e nevojshëm, se plani i situacionit - “zgjdhja urbane”, i propozuar me projekt propozimin e ndërtesave, është në harmoni me kriteret e dokumenteve të planifikimit hapësinor për atë hapësinë, si dhe në harmoni me Vendimin 14nr.350/05 – 0069714/18 dt.22.03.2018 të Kryetarit të Komunës së Prishtinës, konstatoi se janë plotësuar të gjitha kriteret e parapara ligjore për caktimin e kushteve ndërtimore për hartimin e dokumentacionit ndërtimor / projektin kryesor për ndërtimin e kompleksit me ndërtesa shumëbanesore afariste, në kuadër të Bllokut Urban “A2”, Tërësia “A” të Planit Rregullues “Lakrishte” në Prishtinë, konkretisht parcelave kadastrale nr.7493-5, 7495-3, 7490-2, 7493-7, ZK.Prishtinë.

Nga sa u cek më lartë, u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

Shtojcë: Situacioni i ngushte nga plani rregullues me zgjidhjen urbane, manuali gjeodezik për këmbim, ndarje bashkim dhe kompenzim.

Udhëzimi juridik: Pala e pakënaqur me këtë vendim me ankesë mund ti drejtohet kësaj drejtorie brenda afatit prej 30 ditësh, duke llogaritur nga dita e marrjes në dorëzim të vendimit. Bazuar në vlerësimin nga kjo drejtori, ankesa do të shqyrtohet apo do të përcillet te organi epror – MEA, Departamenti Ligjor i Ambientit.

I dorëzohet: Kërkuessit, Drejtorisë së pronës, Qendrës për shërbim me qytetarë, kësaj drejtorie dhe në dosje të lëndës 05 Nr.350/02– 14932/21 dt.25.01.2021.

I dërgohet përmes postës elektronike: Drejtorisë për Pronën, Drejtorisë për Kadastër, Drejtorisë për Investime Kapitale dhe Menaxhim të Kontratave, Drejtorisë për Planifikim Strategjik dhe Zhvillimit të Qëndrueshëm.

**DREJTORIA E URBANIZMIT E KOMUNËS SË PRISHTINËS,
05 NR. 350/02 – 14932/21 DT. 12.03.2021**

Zyrtari:
Anita Osmani,




U.D. Udhëheqëse e Sektorit:
Mimoza Berisha Prestreshi,



Drejtori:
Ardjan Olluri.





OBJEKTI 1	Sipërfaqe nentokë	10294 m ²
	Sipërfaqe mbitokë	13286.6 m ²
	Sipërfaqe Totale	23580.6 m ²
OBJEKTI 2	Sipërfaqe nentokë	5276.55 m ²
	Sipërfaqe mbitokë	17668 m ²
	Sipërfaqe Totale	22944.55 m ²
OBJEKTI 3	Sipërfaqe nentokë	4762.6 m ²
	Sipërfaqe mbitokë	13368.9 m ²
	Sipërfaqe Totale	18131.5 m ²
OBJEKTI 4	Sipërfaqe nentokë	3632.55 m ²
	Sipërfaqe mbitokë	12919.95 m ²
	Sipërfaqe Totale	16552.5 m ²
OBJEKTI 5	Sipërfaqe nentokë	5188.8 m ²
	Sipërfaqe mbitokë	12390.75 m ²
	Sipërfaqe Totale	17579.55 m ²
OBJEKTI 6	Sipërfaqe nentokë	1378.8 m ²
	Sipërfaqe mbitokë	705 m ²
	Sipërfaqe Totale	2083.8 m ²

Sipërfaqe totale Nëntoka 30533.3 m²
Sipërfaqe totale mbi tokë 70339.2 m²
TOTAL NDERITIM 100872.5 m²

Shetëri/Countryside: Republika e Kosovës
 Qyteti/City: Prishtinë
 Lokacioni/Location: Laktishë

Projekti/Design project:
 Objekti A/katëror - Banesore / Asimtare

Faza/Phase:
 Projekti Konceptual

Emërtimi i faqes:
 Situacioni Ngushtë

Page file:
 Përfaqja/Scale:
 1:695

Nr. i fletës / Page no.:
 12

Data/Date:
 19/01/2021

Ndërmarrja publike banesore Sh.A.
 Departamenti i Planifikimit, Projektimit
 dhe Mbikëqarjes

Msc arch. Elez Podrimja
 Msc arch. Vjollca Podvorica, IDA
 Msc arch. Edona Murseli

Arch. Dardan Kuçi
 Arch. Driton Zogaj

Shënim / Note:

Shënim / Note:

Shënim / Note:

Shënim / Note:

Shënim / Note:

Shënim / Note:

Shënim / Note:

Baza e Përdheshës	Baza e Katit karakteristik	Baza e Suteranit	Nëntoka
OBJEKTI 1	OBJEKTI 1	OBJEKTI 1	OBJEKTI 1
OBJEKTI 2	OBJEKTI 2	OBJEKTI 2	OBJEKTI 2
OBJEKTI 3	OBJEKTI 3	OBJEKTI 3	OBJEKTI 3
OBJEKTI 4	OBJEKTI 4	OBJEKTI 4	OBJEKTI 4
OBJEKTI 5	OBJEKTI 5	OBJEKTI 5	OBJEKTI 5
OBJEKTI 6	OBJEKTI 6	OBJEKTI 6	OBJEKTI 6
TOTAL	TOTAL	TOTAL	TOTAL

Baza e Përdheshës	Baza e Katit karakteristik	Baza e Suteranit	Nëntoka
OBJEKTI 1	OBJEKTI 1	OBJEKTI 1	OBJEKTI 1
OBJEKTI 2	OBJEKTI 2	OBJEKTI 2	OBJEKTI 2
OBJEKTI 3	OBJEKTI 3	OBJEKTI 3	OBJEKTI 3
OBJEKTI 4	OBJEKTI 4	OBJEKTI 4	OBJEKTI 4
OBJEKTI 5	OBJEKTI 5	OBJEKTI 5	OBJEKTI 5
OBJEKTI 6	OBJEKTI 6	OBJEKTI 6	OBJEKTI 6
TOTAL	TOTAL	TOTAL	TOTAL

Baza e Përdheshës	Baza e Katit karakteristik	Baza e Suteranit	Nëntoka
OBJEKTI 1	OBJEKTI 1	OBJEKTI 1	OBJEKTI 1
OBJEKTI 2	OBJEKTI 2	OBJEKTI 2	OBJEKTI 2
OBJEKTI 3	OBJEKTI 3	OBJEKTI 3	OBJEKTI 3
OBJEKTI 4	OBJEKTI 4	OBJEKTI 4	OBJEKTI 4
OBJEKTI 5	OBJEKTI 5	OBJEKTI 5	OBJEKTI 5
OBJEKTI 6	OBJEKTI 6	OBJEKTI 6	OBJEKTI 6
TOTAL	TOTAL	TOTAL	TOTAL

Baza e Përdheshës	Baza e Katit karakteristik	Baza e Suteranit	Nëntoka
OBJEKTI 1	OBJEKTI 1	OBJEKTI 1	OBJEKTI 1
OBJEKTI 2	OBJEKTI 2	OBJEKTI 2	OBJEKTI 2
OBJEKTI 3	OBJEKTI 3	OBJEKTI 3	OBJEKTI 3
OBJEKTI 4	OBJEKTI 4	OBJEKTI 4	OBJEKTI 4
OBJEKTI 5	OBJEKTI 5	OBJEKTI 5	OBJEKTI 5
OBJEKTI 6	OBJEKTI 6	OBJEKTI 6	OBJEKTI 6
TOTAL	TOTAL	TOTAL	TOTAL

Baza e Përdheshës	Baza e Katit karakteristik	Baza e Suteranit	Nëntoka
OBJEKTI 1	OBJEKTI 1	OBJEKTI 1	OBJEKTI 1
OBJEKTI 2	OBJEKTI 2	OBJEKTI 2	OBJEKTI 2
OBJEKTI 3	OBJEKTI 3	OBJEKTI 3	OBJEKTI 3
OBJEKTI 4	OBJEKTI 4	OBJEKTI 4	OBJEKTI 4
OBJEKTI 5	OBJEKTI 5	OBJEKTI 5	OBJEKTI 5
OBJEKTI 6	OBJEKTI 6	OBJEKTI 6	OBJEKTI 6
TOTAL	TOTAL	TOTAL	TOTAL

Baza e Përdheshës	Baza e Katit karakteristik	Baza e Suteranit	Nëntoka
OBJEKTI 1	OBJEKTI 1	OBJEKTI 1	OBJEKTI 1
OBJEKTI 2	OBJEKTI 2	OBJEKTI 2	OBJEKTI 2
OBJEKTI 3	OBJEKTI 3	OBJEKTI 3	OBJEKTI 3
OBJEKTI 4	OBJEKTI 4	OBJEKTI 4	OBJEKTI 4
OBJEKTI 5	OBJEKTI 5	OBJEKTI 5	OBJEKTI 5
OBJEKTI 6	OBJEKTI 6	OBJEKTI 6	OBJEKTI 6
TOTAL	TOTAL	TOTAL	TOTAL

Sipërfaqe totale Nëntoka 30533.3 m²
Sipërfaqe totale mbi tokë 70339.2 m²
Sipërfaqe Gjelbërim 7.032.5 m²

Për ngastrat kadastrale me sipërfaqe mbi 1000 m²
 Etazhitefi maksimal - i pa limituar
 ISHP max = 0.5
 ISD max = 4.0
 ISHP për Suleren max = 0.5
 ISHN për Bodrum max = 0.6
Ngastrat Kadastrale: 7490-2; 7493-3; 7493-5; 7493-7
TOTAL Parcela në koeficient





Republika e Kosovës
 Republika Kosova-Republic of Kosova
 Qeveria -Vlada-Government

Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor /Ministarstvo Sredine i Prostornog Planiranja/Ministry of Environment and Spatial Planning

AGJENCIA KADASTRALE E KOSOVËS/ KATASTARSKA AGENCIJA KOSOVA/ KOSOVA CADASTRAL AGENCY

Zyra kadastrale komunale / Opštinska katastarska kancelarija: Prishtinë

Nr. i njesisë kad./ Broj kat.jediniçe 7490-2,7495-3,7495-5,7493-7

Zona kadastrale / Katastarska zona: Prishtinë 2020

Numri i lëndës / Broj predmeta: _____

Lloji i njesisë kadastrale / Vrsta katastarske jediniçe : Parcelë

Shkalla e zvoglimit / Razmera plana 1: 1500


Nr.Rendit	Parcela	Provat	Shprehja e njesisë	Shprehja e njesisë	Shprehja e njesisë	Total	€ paravizuar
Parcela Kadastrale 7490-2							
1	7490-2	nrp	18		A-3	18	
2	7490-2	nrp		38	Lumi	38	
3	7490-2	nrp	42		A-7	42	
4	7490-2	nrp			Rrugë		114
5	7490-2	nrp	94		A-5	94	
6-1	7490-2	nrp		694			
6-2	7490-2	nrp		82	Lumi	82	
7	7490-2	nrp	2996		A-2	2996	
8	7490-2	nrp	33		Rrugë	33	
Total:						3150	847
						3997	4111
Parcela Kadastrale 7495-3							
9	7495-3	nrp	1103		A-7	1103	
10	7495-3	nrp		44	Rrugë	44	
Total:						1103	44
							1147
Parcela Kadastrale 7495-5							
11	7495-5	nrp	9272		A-2	9272	
12	7495-6	nrp		1427	Rrugë	1427	
13	7495-7	nrp	589		A-6	589	
14	7495-8	nrp	302		A-8	302	
Total:						9861	1729
							11590
Parcela Kadastrale 7495-7							
15	7495-7	nrp		78	A-8	78	
16	7495-7	nrp		902	Rrugë	902	
Total:						980	980
Parcela Kadastrale 7773-1							
17	7773-1	P.SAJUKA	694		A-2	694	
Total:						694	694
Parcela Kadastrale 7495-7							
15	7495-7	nrp		1000	A-8	1000	
Total:						1000	1000

1	7512214.420	4723946.790
2	7512224.494	4723940.364
3	7512228.315	4723937.927
4	7512237.683	4723933.235
5	7512246.344	4723928.897
6	7512245.672	4723923.554
7	7512237.245	4723929.405
8	7512224.232	4723938.439
9	7512214.125	4723945.456
10	7512211.606	4723934.051
11	7512222.838	4723926.016
12	7512236.158	4723916.768
13	7512245.379	4723910.366
14	7512244.934	4723908.767
15	7512235.568	4723898.294
16	7512235.579	4723901.656
17	7512235.737	4723908.290
18	7512236.158	4723916.768
19	7512222.216	4723918.109
20	7512221.820	4723910.724
21	7512221.603	4723903.338
22	7512221.560	4723896.596
23	7512221.686	4723889.092
24	7512221.968	4723882.108
25	7512222.274	4723877.024
26	7512225.863	4723886.419
27	7512231.243	4723893.458
28	7512221.252	4723874.349
29	7512220.352	4723863.679
30	7512225.591	4723844.540
31	7512223.140	4723830.810
32	7512220.690	4723810.671
33	7512224.129	4723807.471
34	7512231.279	4723797.241
35	7512231.599	4723791.472
36	7512234.348	4723777.072
37	7512237.998	4723768.912
38	7512238.256	4723764.525
39	7512238.378	4723762.452
40	7512237.298	4723760.562

41	7512228.557	4723758.273
42	7512227.922	4723761.088
43	7512224.128	4723777.882
44	7512218.969	4723796.742
45	7512216.701	4723806.432
46	7512214.000	4723817.971
47	7512211.130	4723823.301
48	7512191.061	4723841.031
49	7512181.161	4723849.751
50	7512168.012	4723861.170
51	7512151.120	4723876.360
52	7512153.796	4723879.597
53	7512167.590	4723871.670
54	7512163.870	4723865.160
55	7512191.130	4723841.290
56	7512196.530	4723865.750
57	7512202.700	4723893.730
58	7512149.100	4723878.070
59	7512137.631	4723887.879
60	7512116.425	4723859.122
61	7512105.430	4723844.813
62	7512103.406	4723841.951
63	7512101.201	4723837.223
64	7512099.317	4723833.674
65	7512097.656	4723829.519
66	7512096.391	4723824.341
67	7512095.937	4723819.418
68	7512096.224	4723814.171
69	7512097.468	4723808.450
70	7512099.566	4723803.193
71	7512102.266	4723798.656
72	7512106.032	4723794.157
73	7512108.447	4723791.922
74	7512111.295	4723788.838
75	7512113.143	4723787.226
76	7512115.687	4723785.477
77	7512141.862	4723768.229
78	7512140.590	4723766.299
79	7512162.602	4723752.573
80	7512166.260	4723757.296

81	7512216.701	4723806.432
82	7512201.310	4723783.751
83	7512167.235	4723740.908
84	7512157.615	4723728.813
85	7512155.297	4723727.927
86	7512158.576	4723733.452
87	7512155.734	4723743.855
88	7512116.399	4723781.534
89	7512086.738	4723800.101
90	7512085.942	4723801.992
91	7512084.983	4723804.665
92	7512083.940	4723808.425
93	7512083.269	4723811.952
94	7512082.871	4723815.630
95	7512082.771	4723819.235
96	7512082.996	4723823.241
97	7512083.618	4723827.448
98	7512084.682	4723831.750
99	7512086.265	4723836.184
100	7512074.090	4723818.470
101	7512040.625	4723839.975
102	7512035.179	4723832.440
103	7512065.390	4723813.464
104	7512018.902	4723842.654
105	7512008.030	4723849.440
106	7512013.850	4723857.180
107	7512007.040	4723861.560
108	7512001.234	4723853.685
109	7511994.943	4723857.614
110	7512014.964	4723885.232
111	7512035.975	4723913.921
112	7512063.930	4723952.250
113	7512069.950	4723946.880

114	7512222.537	4723873.485
115	7512222.935	4723868.942
116	7512223.911	4723860.053
117	7512225.784	4723847.229
118	7512227.497	4723837.897
119	7512230.446	4723824.692
120	7512230.390	4723824.340
121	7512231.180	4723820.961
122	7512233.450	4723810.411
123	7512234.729	4723808.989
124	7512236.068	4723804.417
125	7512237.887	4723798.206
126	7512239.547	4723792.540
127	7512241.037	4723787.451
128	7512242.994	4723780.768
129	7512246.908	4723767.402
130	7512011.247	4723880.105
131	7512017.504	4723875.752
132	7512217.586	4723929.774
133	7512220.512	4723941.022
134	7512236.903	4723916.251
135	7512237.811	4723929.012



Rilevoi / Snimio: Haki Selmani
 (emri dhe mbiemri i gjeodetit/kompanisë/ ime i prezime geodeta/ kompanije)

Aprovoi / Usvojio: _____
 (emri dhe mbiemri i përsoneit zyrtar/ ime i prezime shërbëtorit)

Nr. i licencës / Br. licence: 11

Nënshkrimi / Potpis: _____

Nënshkrimi / Potpis:

Data e aprovimit / Datum usvajanja: _____

Data e rilevimit / Datum snimanja: 10.03.2021

Regjistri i fletëparaqitjeve/ S. prijava _____





Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria -Vlada-Government

Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor /Ministarstvo Sredine i Prostornog Planiranja/Ministry of Environment and Spatial Planning

AGJENCIA KADASTRALE E KOSOVËS/ KATASTARSKA AGENCIJA KOSOVA/ KOSOVA CADASTRAL AGENCY

Zyra kadastrale komunale / Opštinska katastarska kancelarija: Prishtinë

Nr. i njesisë kad./ Broj kat.jedinice 7493-7 dhe 7773-1

Zona kadastrale / Katastarska zona: Prishtinë 2020


Numri i lëndës / Broj predmeta: _____

Lloji i njesisë kadastrale / Vrsta katastarske jedinice : Parcelë

Shkalla e zvoglimit / Razmera plana 1: 1500

Propozim për kompenzim të pronave (Ndërrim i pjesëve të P-7773-1 dhe 7493-7)

Pjesë e P-7773-1			Pjesë e parcelës 7490-2		
25	7512222.274	4723877.024	6	7512245.672	4723923.554
26	7512225.863	4723886.419	7	7512237.245	4723929.405
27	7512231.243	4723893.458	15	7512235.568	4723898.294
28	7512221.252	4723874.349	16	7512235.579	4723901.656
29	7512220.352	4723863.679	17	7512235.737	4723908.290
30	7512225.591	4723844.540	18	7512236.158	4723916.768
31	7512223.140	4723830.810	19	7512222.316	4723918.109
32	7512220.690	4723810.671	20	7512221.820	4723910.724
33	7512224.129	4723807.471	21	7512221.603	4723903.338
34	7512231.279	4723797.241	22	7512221.560	4723896.596
35	7512231.599	4723791.472	23	7512221.686	4723889.092
36	7512234.348	4723777.072	24	7512221.968	4723882.108
37	7512237.998	4723768.912	25	7512222.274	4723877.024
38	7512238.256	4723764.525	26	7512225.863	4723886.419
114	7512222.537	4723873.485	27	7512231.243	4723893.458
115	7512222.935	4723868.942	132	7512217.586	4723929.774
116	7512223.911	4723860.053	133	7512220.512	4723941.022
117	7512225.784	4723847.229	134	7512236.903	4723916.251
118	7512227.497	4723837.897	135	7512237.811	4723929.012
119	7512230.446	4723824.692			
120	7512230.390	4723824.340			
121	7512231.180	4723820.961			
122	7512233.450	4723810.411			
123	7512234.729	4723808.989			
124	7512236.068	4723804.417			
125	7512237.887	4723798.206			
126	7512239.547	4723792.540			
127	7512241.037	4723787.451			
128	7512242.994	4723780.768			
129	7512246.908	4723767.402			



- P.SH Ujrat
- Ndërrmarja Publike Banesore

Rilevoi / Snimio: Haki Selmani
(emri dhe mbiemri i gjeodetit/kompanisë/ ime i prezime geodeta/ kompanije)
Nr. i licencës / Br. licence: 11
Nënshkrimi / Potpis:
Data e rilevimit / Datum snimanja: 10.03.2021



Aprovoi / Usvojio: _____
(emri dhe mbiemri i përsosnit zyrtar/ ime i prezime sluzbenog lica)
Nënshkrimi / Potpis: _____
Data e aprovimit / Datum usvajanja: _____
Regjistri i fletëparaqitjeve/ S. prijava _____